



UNMIK

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Raport nga tryezat e rrumbullakëta të Komisioni për Buxhet dhe Financa me  
institucionet / agjencionet e pavarura**

Organizuar nga:

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Njësia Qendrore për Kuvendin, Misioni i OSBE-së në Kosovë

**16-17 korrik 2007**

---

**Tabela e përmbajtjes**

1. Qëllimet e takimeve
2. Agjenda e takimeve
3. Institucionet/agjencionet ftuara

Dt. 16.07.07-

- a. Agjencioni Kosovar i Anti Korrupsionit
- b. Këshilli i Komisionit të pavarur për Media
- c. Institucioni i Ombudspersonit
- d. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- e. Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- f. Instituti Gjyqësor i Kosovës

Dt. 17.07.07-

- a. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
  - b. Zyra e Rregullatorit të Energjisë
4. Konkluzionet e përgjithshme
  5. Lista e pjesëmarrësve në takime

## **1. Qëllimet e takimeve**

Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës, në bashkëpunim me Njësinë Qendrore për Kuvendin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, realizoi dy takime me agjencionet/institucionet e pavarura të themeluara me vendim të Kuvendit të Kosovës.

Sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni ka për qëllime kryesore: Shqyrtimin e çështjeve buxhetore e financiare, buxhetit vjetor të IPVQ-ve; garantimin se të gjitha projektligjet që kanë implikime buxhetore do të shoqërohen nga një deklaratë financiare; kontrollimin e raporteve vjetore dhe të pasqyrave të kontrolluara financiare të Fondit të Konsoliduar të Kosovës që lidhen me buxhetin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe me raportet e tjera të revizioneve financiare që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit, të Kryetarit, të Qeverisë, të ministrave të mbështetura drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të tërthortë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Agjencionet e pavarura që funksionojnë në Kosovë, emërohen nga Kuvendi me propozim të Qeverisë dhe janë plotësisht të pavarura nga Qeveria si nga aspekti i rregullimit të çështjeve nga përgjegjësitë e tyre po ashtu edhe nga aspekti financiar.

Në procesin e miratimit të Buxhetit të Konsoliduar, Kuvendi me propozimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, miraton buxhetet për këto agjencione të cilat më pas përfshihen si pjesë përbërëse të Buxhetit të Konsoliduar. Kjo nënkupton, se Komisioni është ekskluzivisht i kyçur në shqyrtimin e kërkesave buxhetore të agjencioneve të pavarura dhe përgatitjen e propozim buxheteve të tyre.

Gjatë këtij procesi, Kuvendi ka hasur në vështirësi të ndryshme, si për nga mos harmonizimi i rregullimit të procesit buxhetor me ligjet e këtyre agjencioneve/institucioneve, e po ashtu edhe ndërhyrjet e MEF-it me shkurtimet buxhetore që shkakton vështirësi në aktivitetet e këtyre agjencioneve dhe cenon pavarësinë e tyre.

Me qëllim të përgatitjes së dëgjimeve për vitin 2008 si dhe me qëllim të zbatimit të përgjegjësive për mbikëqyrje parlamentare, komisioni së bashku me OSBE-në ka organizuar këto dy takime të rumbullakëta, për të shqyrtuar në kontekstin e përgjithshëm buxhetin e institucioneve të pavarura.

## **2. Agjenda e takimeve**

Temat që janë parashtruar për diskutim në këto takime ishin:

- a. Bazat legjislative për pavarësinë buxhetore të Institucioneve /Agjencioneve të pavarura
- b. Sfidat e ndryshme gjatë procesit buxhetor
- c. Nivelet e pagave të drejtorëve dhe anëtarëve të bordeve
- d. Buxheti i Sekretariatit: garantimi i mbështetjes së duhur profesionale, administrative, logjistike
- e. Rekomandimet për sigurimin e pavarësisë buxhetore në të ardhmen

### **3. Institucionet / agjencionet e ftuara**

Varësisht nga specifikat dhe problemet me që cilat ballafaqohen, institucionet / agjencionet e pavarura janë ndarë në dy grupe dhe janë ftuar gjatë dy ditëve në takimet e organizuara.

Me 16 korrik 2007 janë ftuar:

#### **a. Agjencioni Kosovar i Anti Korrupsionit**

Ky agjencion është themeluar në bazë të Ligjit kundër Korrupsionit, nr. 2004/34.

Ligji është i aplikueshëm së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut për shpalljen e tij, nr. 2005/26 të datës 12.05.2005.

Ky ligj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të strategjisë kundër korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve administrative të korrupsionit publik, eliminimin e shkaqeve të të korrupsionit, papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e punëve në detyrë, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publikë duke kryer biznes me firmat ku personi zyrtari ose një person në marrëdhënie të afërt me të është i përfshirë.

#### **b. Këshilli i Komisionit të pavarur për Media**

Ky këshill është themeluar në bazë të Ligjit për Komisionin e pavarur për media dhe transmetim, nr. 2005/02-L15. Ligji është i aplikueshëm së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut për shpalljen e tij, nr. 2005/34 të datës 08.07.2005.

Ligji autorizon KPM-në të rregullojë Spektrin e Frekuencave Transmetuese në Kosovë si dhe licencon transmetuesit publik dhe privat për t'i përdorur ato, në pajtueshmëri me praktikat më të mira Evropiane, duke përfshirë, pos të tjerash, zbatimin e politikës së transmetimit që do ta përcaktojë Këshilli.

#### **c. Institucioni i Ombudspersonit**

Ky institucion është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut mbi Institucionin e Avokatit të Popullit, nr.2006/06

Rregullorja autorizon Institucionin e Avokatit të Popullit të mbikëqyr, avancojnë dhe mbron të drejtat dhe liritë e banorëve të përhershëm të Kosovës dhe të personave fizikë e juridikë në territorin e Kosovës, për të siguruar që të gjithë personat e tillë të kenë mundësi të ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale, të mbrojtura me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të përfshira në ligjin në fuqi

#### **d. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik**

Ky komision është themeluar në bazë të Ligjit për prokurimin publik në Kosovë, nr.2003/17. Ligji është i aplikueshëm së bashku me ndryshimet e dt.8 shkurt 2007.

Ligji siguron mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

#### **e. Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Ky këshill është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut për themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nr. 2005/52.

Me anë të kësaj Rregulloreje themelohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për përcaktimin e politikave të punësimit, aftësimit, emërimit, vlerësimit, avancimit në punë, transferimit dhe disiplinimit të gjyqtarëve, gjyqtarëve laik dhe punonjësve të tjerë jo gjyqësor.

#### **f. Instituti Gjyqësor i Kosovës**

Ky institut është themeluar në bazë të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, nr. 2006/02-L25. Ligji është i aplikueshëm së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut për shpalljen e tij nr. 2006/23 të datës 24.04.2006.

Ligji fuqizon IGJK-në si organ të pavarur i cili vepron në bashkëpunim me KGJPK-në ose Institucionet të cilat trashëgojnë përgjegjësitë e tij për koordinimin e nevojave për aftësimin profesional të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës, për aftësimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor të Kosovës.

Me 17 korrik 2007 janë ftuar:

##### **a. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit**

Ky autoritet është themeluar në bazë të Ligjit për Telekomunikacionin, nr.2002/7. Ligji është i aplikueshëm së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut për shpalljen e tij nr. 2003/16 të datës 12.05.2003.

Ligji qeveris të gjitha shërbimet e telekomunikacionit dhe të gjithë ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë dhe do të krijojë një ambient ligjor, rregullator dhe transparent, i cili do të promovojë investimet dhe konkurrencën e lirë, për t'i përmbushur nevojat e të gjithë shfrytëzuesve për shërbime të telekomunikacionit.

##### **b. Zyra e Rregullatorit të Energjisë**

Kjo zyre është themeluar në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, nr.2004/9. Ligji është i aplikueshëm së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut për shpalljen e tij nr. 2004/20 të datës 30.06.2004.

Ligji themelon Rregullatorin e Pavarur për Energji dhe përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji; kushtet për nxjerrjen e liçencës për të kryer aktivitete në fushën e energjisë; procedurat për dhënjen e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese; kriteret për rregullimin e çmimeve dhe kushtet për furnizim me energji.

#### **4. Konkluzionet e përgjithshme**

Përmbledhja e konkluzioneve e përgjithshme, rekomandimeve dhe qëndrimeve e marra gjatë këtyre dy takimeve, janë paraqitur si më poshtë, ndaras sipas ditëve të mbajtjes.

Dita e parë, dt. 16.07.2007-

*Rekomandimet dhe komentet e shfaqura nga diskutimet e përfaqësuesve të institucioneve / agjencioneve të pavarura:*

- Duhet të ketë një shqyrtim të pozitës financiare të pushtetmbajtësve në institucionet e pavarura, duke përfshirë legjislacionin të mundshëm.
- Nëse institucionet janë përgjegjëse ndaj Kuvendit, atëherë Kuvendi duhet të aprovojë buxhetin e tyre. Aktualisht, Kuvendi aprovon buxhetin e tyre por ky buxhet reduktohet më pas nga Qeveria.
- Kur rrogat e nëpunësve nuk janë të rregulluara me ligj për të qenë konkurruese, kjo është një sfidë për institucionet e pavarura në mbajtjen e stafit profesional dhe të një strukture organizative të qëndrueshme.
- Përkundër pavarësisë financiare të paraparë me kornizat legjislative të institucioneve të pavarura, kjo nuk garanton gjithnjë që këto institucione kanë pavarësi buxhetore. Shpesh, çështja është tek zbatimi dhe interpretimi i ligjit.
- Kuvendi duhet të luaj një rol efektiv në ndihmë zbatimit e ligjeve ekzistuese.

*Vërejtjet dhe qëndrimet e anëtarëve të komisionit:*

- Shqyrtimi nga komisioni për zgjidhjen e çështjes së institucioneve të pavarura do të orientohet në shqyrtimin e legjislacionit të tyre në mënyrë specifike që të garantoj pavarësi buxhetore të institucioneve/ agjencioneve të pavarura.
- Çdo vit institucionet/ agjencionet përballen me të njëjtat vështirësi. Komisioni shpreson se së bashku me OSBE-në do të mund të rishqyrtojnë legjislacionin në mënyrë që këtyre institucioneve t'u garantohet pavarësia financiare dhe të bëhen përgjegjëse para Kuvendit.

*Vërejtjet dhe qëndrimet e përfaqësuesve të OSBE-së:*

- Institucionet e pavarura janë të rëndësishme për një shoqëri demokratike apo mbikëqyrje të ekzekutivit dhe rregullimin e sektorit publik.
- Institucionet duhet të jenë të pavarura: disa përballen me vështirësi. Është roli i Kuvendit të garantojë pavarësinë e tyre financiare.
- Kjo s' do të thotë se ato janë jo përgjegjëse. Ato duhet të jenë përgjegjëse ndaj publikut përmes Kuvendit.

*Zgjidhje të mundshme të propozuara nga komisioni:*

- Komisioni së bashku me ekspert që do të angazhoj OSBE-ja do të rishqyrtoj legjislacionin në mënyrë që të qartësojë pavarësinë dhe përgjegjësinë financiare të tyre.
- Komisioni do të angazhohet edhe më shumë që Agjencioni Anti Korrupsion të ketë kushte më të mira financiare dhe kadrovike, që do të garanton efektshmërinë e tij.
- Komisioni do të jetë më aktiv që të shikoj mundësinë e trajtimit financiar më të mirë ndaj gjyqësorit të Kosovës.

- Ministri i Financave të thirret në takim me komisionin për shqyrtimin e problemeve të identifikuar lidhur me këto institucione / agjencione
- Komisioni përmes Kryesisë së Kuvendit ti drejtohet me një shkresë me rekomandime Qeverisë
- Komisioni do të dëgjojë brengat e institucioneve/ agjencioneve të pavarura dhe do të përgatis një raport dhe të dërgojë së paku nga një anëtarë të tij në MEF për të prezantuar konkluzionet e komisionit gjatë dëgjimeve buxhetore.

Dita e dytë, dt. 17.07.2007-

*Rekomandimet dhe komentet e shfaqura nga diskutimet e përfaqësuesve të institucioneve / agjencioneve të pavarura:*

- Është vështirë të mbahet dhe rekrutohet personel profesional, kur pagat janë zvogëluar nga ana e Qeverisë ose kur niveli i pagës është i atillë që ata që inspektojnë paguhen shumë herë më pak se ata që inspektohen prej tyre.
- Kuadrot profesionale që përfshijnë ekspertë të trajnuar mirë për punët specifike në këto institucione, duhet të trajtohen dhe paguhen si persona publik, e jo si personeli civil që i nënshtrohet Ligjit mbi shërbyesit civil.
- Pagesa dhe kompensimi jo i mjaftueshëm kanë ndikuar negativisht duke lëshuar punën shumica e kuadrit profesional në këto institucione, për trajnimin e të cilëve janë shpenzuar mjete të mëdha buxhetore.
- Ligjet ekzistuese nuk janë pengesë, përforcimi në zbatimin e tyre është problemi.
- Buxhetet e institucioneve/ agjencioneve të pavarura janë të vogla në krahasim me rezultatet e tyre, sidomos kur disa prej agjencioneve grumbullojnë shuma të mëdha mjetesh financiare përmes licencave. Efekti negativ i zvogëlimit të buxheteve të tyre do të mund të ndjehet për dekada.
- Paraqiten vështirësi lidhur me disa kërkesa shtesë të imponuara ndaj institucioneve/ agjencioneve të pavarura për raportim pranë Departamentit të Thesarit, gjë që me ligjet e tyre nuk është e përcaktuar.
- Problemet me të cilat ballafaqohen këto institucione/ agjencione përsëriten çdo vit.

*Vërejtjet dhe qëndrimet e anëtarëve të komisionit:*

- duhet të ndërmerren hapat e duhur që propozimet për buxhetin e institucioneve /agjencioneve të pavarura pas miratimit në Kuvend, të respektohen dhe të mos ndryshohen nga ana e Qeverisë.
- ndryshimet ndërmjet shumave të miratuara nga Kuvendi për këto institucione në kuadër të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK) për vitin 2007, të miratohen gjatë procesit të rishikimit të BKK dhe ti mundësohen institucioneve të dëmtuara ti shfrytëzojnë
- Komisioni është i interesuar që së bashku me OSBE-në të rishikojë legjislacionin e këtyre institucioneve/ agjencioneve dhe të bëjë rekomandime për gjetjen e zgjidhjes në përforcimin e këtyre institucioneve, për të siguruar mbajtjen dhe rekrutimin e kuadrove profesionale, duke u bërë këto institucione profesionalisht të afta për të menaxhuar veprimtarinë e tyre dhe realizuar përgjegjësitë në bazë të ligjit, e kjo do të arrihet kur ato të jenë financiarisht të pavarura dhe përgjegjëse para Kuvendit.

*Vërejtjet dhe qëndrimet e përfaqësuesve të OSBE-së:*

- Institucionet e pavarura janë të rëndësishme për një shoqëri demokratike apo mbikëqyrje të ekzekutivit dhe rregullimin e sektorit publik.
- Institucionet duhet të jenë të pavarura: disa përballen me vështirësi. Është roli i Kuvendit të garantojë pavarësinë e tyre financiare.
- Kjo s' do të thotë se ato janë jo përgjegjëse. Ato duhet të jenë përgjegjëse ndaj publikut përmes Kuvendit.

*Zgjidhje të mundshme të propozuara nga komisioni:*

- Komisioni do të diskutoj me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë që në këtë periudhë të dëgjimeve buxhetore të eliminohen pengesat procedurale të deritashme për agjencione që kanë të hyra vetanake ( ART, ZRrE ).
- Parlamenti të shqyrtojë çështjen e pagesës dhe shpërblimeve të institucioneve/ agjencioneve të pavarura me Qeverinë
- Kërkesen e ZRrE-së për çështjen e pagesës më të mirë për kuadrin profesional, Komisioni do ta ketë parasysh gjatë aprovimit të buxhetit për vitin 2008 dhe do t' i rekomandoj MEF-it që t' i lejoj ZRrE –së shfrytëzimin e mjeteve vetanake për këtë destinim për gjysmë vjetorin e dytë të këtij viti.
- Komisioni së bashku me OSBE-në do të rishikojë legjislacionin e institucioneve / agjencioneve të pavarura për të ofruara zgjidhje dhe mekanizma për zgjidhjen afatgjate të problemeve të paraqitura.
- Komisioni do të ftojë në takim Ministrin e Ekonomisë dhe Financave për shqyrtimin e këtyre çështjeve.

## **5. Lista e pjesëmarrësve në takime**

### **Nga Komisioni:**

1. z. Naser Osmani, Kryetar i komisionit
2. z. Gani Koci, Anëtar
3. z. Lutfi Zharku, Anëtar
4. znj. Safete Hadergjonaj, Anëtare
5. z. Nazim Jashari, Anëtar
6. z. Mazllom Kumnova, Anëtar
7. znj. Naxhije Doçi, Anëtare

### **Nga OSBE-ja:**

1. z. Henry McGowen, u.d. i Shefit të Misionit të OSBE-së në Kosovë
2. z. Franklin DeVireze, Udhëheqës i Njësisë Qendrore për Kuvendin, OSBE
3. znj. Anita Vandenbeld, eksperte pranë OSBE-së
4. z. Ramadan Islami, Asistent Lokal i Zyrtarit të Programit

### **Nga institucionet / agjencionet e pavarura:**

#### *Agjencioni Kosovar i Anti Korrupsionit*

1. z. Hasan Preteni, Drejtor i Agjencionit
2. znj. Eridana Çano, Këshilltare e Drejtorit të Agjencionit

#### *Këshilli i Komisionit të pavarur për Media*

3. znj. Naile Selimaj-Krasniqi, Drejtoreshë ekzekutive
4. z. Arben Bilalli, Shef i Administratës dhe Financave

#### *Institucioni i Ombudspersonit*

5. znj. Hanife Statovci, Drejtoreshë Ekzekutive e

#### *Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik*

Nuk kanë qenë të pranishëm

#### *Këshilli Gjyqësor i Kosovës*

6. z. Halit Muharrem, Drejtor i Sekretariatit të Këshillit
7. z. Vehbi Behluli, Udhëheqës i Departamentit të Financave

#### *Instituti Gjyqësor i Kosovës*

8. z. Lavdim Krasniqi, Drejtor i Institutit

#### *Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit*

9. z. Fatmir Gërvalla, Shef i Departamentit të financave

#### *Zyra e Rregullatorit të Energjisë*

10. z. Ali Hamiti, Drejtor
11. znj. Xhyldane Murtezi, Udhëheqëse e Departamentit të financave

### **Nga sekretaria e Kuvendit:**

1. Ahtere Loxha, Zyrtare Ligjore
2. Arta Hajra, Asistente Ligjore

Raporti i përgatitur nga:  
Arta Hajra, Asistente Ligjore

Kryetari i Komisionit  
Naser Osmani